



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
**Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë**  
[www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net) tel: 0280390112

---

## **UDHËZUESI**

### **për zhvillimin e procesit mësimor në kushte pandemie për semestrin dimëror 2020/2021**

1. Mësimi në UKZ, ligjërata dhe ushtrime, do të mbahet nëpër klasa; mund të mbahet edhe online, sipas nevojës (dekani njoftohet me shkrim në rastet e mësimin onlajn).
2. Dekanët bëjnë ndarjen e studentëve në grupe deri në 30-40 studentë dhe sipas madhësisë së klasave.
3. Dekanët i nënshkruajnë listat e grupeve, i vendosin në ueb faqe, profesorët i shkarkojnë dhe i përdorin për lista të vijueshmërisë; listat e grupeve duhet të respektohen në mënyrë strikte në ligjërata dhe ushtrime.
4. Te lëndët me dy orë ligjërata/javë, te të cilat grupi e kalon numrin prej 80 studentësh, mësimi mbahet në kohëzgjatje prej 180 minutash (3 x 60 min). Grupi i parë 60 min, grupi i dytë 60 min dhe grupi i tretë 60 min; ora e tretë llogaritet si mbinormë e veçantë;
5. Te lëndët, te të cilat grupi e kalon numrin prej 40 studentësh, mësimi mbahet në kohëzgjatje prej 120 minutash (2 x 60 min). Grupi i parë 60 min dhe grupi i dytë 60 min
6. Tek lëndët, te të cilat, grupi nuk e kalon numrin prej 40 studentësh, mësimi mbahet sikurse ka qenë më parë, pra në kohëzgjatje prej 90 minutash (2 x 45 min).
7. Konsultimet profesor-student bëhen në klasë dhe onlajn. Orari i konsultimeve publikohet në orarin mësimor.
8. Distanca e studentëve dhe e stafit akademik duhet të ruhet sipas udhëzimit të IKSHPK-së.
9. Dezinfektimi i sallave dhe i hapësirave tjera duhet të bëhet për çdo mbrëmje, pas përfundimit të procesit mësimor.
10. Rregullat e mbarëvajtjes së mësimin të shkruara në fleta të mëdha të vendosen nëpër koridore dhe dyer të sallave.
11. Në çdo sallë të ketë dezinfektues duarësh.
12. Nuk lejohen grupime të mëdha të studentëve (më shumë se tre persona).
13. Hyrja dhe dalja e studentëve nëpër salla të bëhet një nga një, në radhë: dalin ata që janë në klasë, pastaj hyjnë të tjerët.
14. Mbjajtja maskave është obligative gjatë tërë kohës nga të gjithë personat brenda objektit të UKZ. Stafit akademik dhe studentët nuk lejohen në klasë pa maska.
15. Stafit akademik dhe studentët të cilët nuk i rrespektojnë masat anti-pandemi do të largohen nga objekti i UKZ.

Në Gjilan, 12.10.2020

Miratuar nga Senati i UKZ